



AKTIVIZËM PËRMES VULLNETARIZMIT




Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit "YOUth ACTING" i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit

Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Newsletter
Number

04

- 1 Arritjet e Projektit
- 2 EDITORIAL
Erviola Osmanaj
- 3 Pse YOUth Acting?
- 4 EDITORIAL
Olta Murataj
- 5 Refleksione Rinore

AKTIVIZËM RINOR YOUTH ACTING




- 471 të rinj janë ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e angazhimit në vullnetarizëm dhe në mbështetje komunitare si dhe mbi përfitimet e ndërsjella që vijnë si rezultat i zgjerimit të rrjetëzimit rinor.
- 4 Info Point janë ngritur e vënë në funksion në qytetet Kukës, Korçë, Shkodër e Vlorë të cilat jo vetëm janë më afër qeverisjes lokale e komunitetit përkatës, por shërbejnë edhe si mënyra e ambiente rinore ku të rinjtë mund të ushtrojnë veprimtaritë e tyre vullnetare.
- Forcohet bashkëpunimi mes aktorëve lokalë dhe komunitetit rinor në 4 bashki të vendit ku ka pasur një gatishmëri nga qeverisjet vendore të të 4 qyteteve, jo vetëm në mbështetjen e idesë së projektit por edhe në mundësimin e hapësirave dhe të bashkëpunimit edhe për vendosje të Info Points si dhe në nisma konkrete vullnetare që kulmojnë edhe me maratonën 48-orëshe.

- Katër fushata maratonë janë organizuar gjate muajit tetor në Kukës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë të cilat synuan angazhim masiv të të rinjve në aktivitete vullnetare e në nisma të cilat synojnë përmirësimin e jetës në komunitet e sidomos të grupeve në nevojë.
- 38 aktivitete janë realizuar në total për ndërgjegjësim dhe rritje të pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete vullnetare.
- 506 persona gjithsej janë angazhuar në projekt nga të cilët 319 janë femra.
- 471 të rinj janë angazhuar në aktivitetet e projektit nga të cilët 297 janë vajza.
- 35 persona janë angazhuar në projekt nga të cilët 22 janë gra.
- 18 persona janë pjesëtarë të grupeve të marginalizuara.
- Është rritur shkalla e përfitimit në komunitet nga shërbimet e angazhimit vullnetare jo vetëm për grupet në nevojë por sidomos edhe për institucione të ndryshme e të rinj të tjerë të cilët u nxitën për angazhime të mëtejshme në komunitetin ku bëjnë pjesë.

Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ervjola OSMANAJ
Eksperte për Çështjet Rinore



Shqipëria, kryesisht vitet e fundit ka njohur një zhvillim si në infrastrukture, ashtu dhe në përafërimin e legjislacionit dhe politikave me vendet e Bashkimit Europian. Të rinjtë në vendin tonë përbëjnë rreth 23% të popullsisë, duke u kthyer kështu në pjesën më vitale të shoqërisë, si dhe në potencial të padiskutueshëm zhvillimi si në aspektin intelektual ashtu edhe në atë ekonomik. Pavarësisht kësaj të rinjtë në Shqipëri janë përballuar dhe vijojnë të përballen me sfida dhe vështirësi, të cilat vijojnë të kenë një ndikim tejet negativ në mirëqenien e tyre.

Në këtë kuadër, referuar Vëzhgimit Kombëtar "Rinia: Regres apo Progres?" (gusht 2022) janë një sërë arsyesh dhe faktorësh të cilat kanë ndikuar në uljen e mirëqenjes së tyre, si dhe në rritjen e dëshirës për t'u larguar nga vendi për një jetë dhe të ardhme më të mirë.

Arsimi në Shqipëri është një tjetër fushë prioritare të cilën të rinjtë duket se e kanë "ngelur në klasë". 77% e të rinjve të anketuar e konsiderojnë sistemin arsimor jo cilësor dhe gjithëpërfshirës, ndërkohë 74% e të rinjve të anketuar shprehen se problematikat dhe sfidat e tyre nuk merren parasysh nga institucionet arsimore në Shqipëri.

Punësimi në Shqipëri, sidomos për të rinjtë, është kthyer tashmë në një ndër arsyt kryesore të largimit të tyre nga vendi. Në këtë kuadër, 85% e të rinjve të anketuar shprehen se është shumë e vështirë gjetja e një vendi pune në profesion pas përfundimit të studimeve, ndërkohë 55% e të rinjve të tjerë shprehen se meritokracia nuk funksionon në Shqipëri për të gjetur një vend pune, si dhe 58% e të rinjve shprehen se të rinjtë nuk trajtohen aspak me dinjitet, në rastet kur janë të punësuar.

“Shumë flitet për të rinjtë, por a është vërtet rinia në fokus kryesor?!”

“ Punësimi në Shqipëri, sidomos për të rinjtë, është kthyer tashmë në një ndër arsyt kryesore të largimit të tyre nga vendi. ”

Emigrimi i të Rinjve është kthyer në një plagë të shoqërisë shqiptare. Vendi ynë po përballet, sidomos vitet e fundit, me një valë të jashtëzakonshme emigratore të të rinjve. Kronikat shpeshherë na tregojnë që të rinjtë tanë janë të gatshëm të rrezikojnë dhe jetën e tyre, vetëm për t'u larguar nga vendi. Vetëm në 10 vitet e fundit, mbi 140,000 të rinj janë larguar nga vendi. Ndërkohë të rinjtë e anketuar, shprehen në masën 76% se të ardhmen e tyre e shikojnë larg Shqipërisë, si dhe 58% e të rinjve të anketuar shprehen se nuk do të riktheheshin më në Shqipëri, pasi të largohen. Kaq e zyrtë është situata dhe për Organizatat e Shoqërisë Civile, për të cilat 92% e të rinjve nuk kanë besim tek puna e OSHC-ve. Ndërkohë, 89% e të rinjve të tjerë shprehen se ka pak ose aspak organizata që punojnë vërtet me dhe për të rinjtë.

Ndikimi i politikës, duket se ka afektuar jo pak dhe nivelin e besueshmërisë që të rinjtë kanë tek OSHC-t dhe në këtë aspekt 93% e të rinjve të tjerë shprehen se OSHC-të janë pak ose aspak të pavarura nga politika, si dhe 80% e të rinjve mendojnë se organizatat e shoqërisë civile punojnë më tepër për interesin e tyre sesa për zgjidhjen reale të problematikave të të rinjve.

Përsa më sipër, të gjithë faktorët lartpërmendur, kërkojnë të sjellin në vëmendje të institucioneve vendimarrëse, të gjitha problematikat dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë në Shqipëri, duke nxitur në një dialog të qëndrueshëm pushtetin qëndror dhe atë lokal me fokus ligjet, politikat dhe strategjitë për të rinjtë. Zëri real i çdo të riu/reje në 61 Bashkitë e vendit për të kuptuar drejt gjendjen e tyre në komunitetin ku jetojnë, duhet dëgjuar! Shumë flitet për të rinjtë, por a është vërtet rinia në fokus kryesor?!

EDITORIAL

“Drejtuar të rinjve: Çfarë duhet të dini për Vullnetarizmin?”



Olta MURATAJ, PhD
Sociologe

Përditshmëria e ngarkuar e ditëve, shpërqendrimi që krijon teknologjia, dhe shpesh mosgjëta e motivit “pse duhet bërë” mund të krijojë vështirësi në gjetjen e kohës për tu përfshirë në punë vullnetare.

Njerëzit kanë filluar të kuptojnë se si shërbimi dhe ndihma e njëri-tjetrit dhe komuniteteve të ndryshme sjell përfitime jo vetëm për të tjerët, por edhe për veten tonë. Dhënia për të tjerët mund të ndihmojë gjithashtu në mbrojtjen e shëndetit mendor dhe fizik, një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm i vullnetarizmit.

Mund të reduktojë stresin, të luftojë depresionin, të mbajë të stimuluar mendërisht dhe të sigurojë një ndjenjë qëllimi. Ky angazhim mund të jetë me etapa të shkurtra por i shpeshtë gjatë jetës së secilit. Duke mos harruar se, dhënia edhe në mënyra të thjeshta mund të ndihmojë ata që kanë nevojë dhe të përmirësojë shëndetin dhe lumturinë tuaj.



“Njerëzit kanë filluar të kuptojnë se si shërbimi dhe ndihma e njëri-tjetrit dhe komuniteteve të ndryshme sjell përfitime jo vetëm për të tjerët, por edhe për veten tonë.”

EDITORIAL

“Drejtuar të rinjve: Çfarë duhet të dini për Vullnetarizmin?”

Pyetja më e zakonshme që bëjnë të rinjtë lidhet me dilemën e tyre se në cilën punë vullnetare të përfshihen. Ne ju rekomandojmë se, për të gjetur një pozicion vullnetar që është i duhuri për ju, kërkoni diçka që përputhet me personalitetin, aftësitë dhe interesat tuaja.

Pyesni veten nëse ka diçka specifike që dëshironi të bëni ose të arrini si vullnetar. Për shembull, disa nga dëshirat tuaja mund të jenë: kontribut në komunitetin ku jetoni si përmirësimi i lagjes tuaj; të takoni njerëz të rinj me pikëpamje ose përvoja të ndryshme; të provoni diçka të re; të bëni diçka të dobishme me kohën tuaj të lire; të shihni vende të reja ose përjetoni një mënyrë tjetër jetese; të provoni një lloj të ri pune që mund të dëshironi ta ndiqni si punë me kohë të plotë; apo të zgjeroni interesat dhe pasionet tuaj.

Gjithmonë mbani në vëmendje se, lumturia shtohet duke e shpërndarë me të tjerët dhe jo duke e izoluar brenda botës tonë, ashtu siç Albert Schëeitzer e ka shprehur “kudo rreth jush, mund të gjeni dikë që ka nevojë për ju. Edhe nëse është një gjë e vogël, bëni diçka për të cilën nuk ka pagesë, por privilegjin që e keni bërë atë gjë. Mbani mend, ju nuk jetoni vetëm në botën tuajën.”

Vullnetarizimi në Shqipëri diçka që sa vjen dhe bëhet më e madhe . Diçka që të rinjtë duan të marrin pjesë dhe të jene dhe vetë ato organizuesit e një grupi vullnetar për të ndihmuar të tjerët.

Kohët e fundit të rinjte shqiptarë janë marrë shumë me vullnetarizmin që në momentin që ra termeti në 26 Nentor 2019.

Une vete personalisht jam marrë me punë vullnetarizmi që në një moshë të vogël duke ndihmuar rreth e qark vendit ku jetoja e deri më sot që kam marrë pjesë në ndihmat që organizohen dhe jam një nga ato personat që dua me domosdoshmëri që të rinjtë të jenë sa më shumë vullnetarë dhe të kenë atë shpirtin e vullnetarit.

Të qenurit vullnetar është diçka shumë e mirë dhe të bën të ndihesh një person që je në të mirë të qytetarëve dhe çdokush të do.

Do ju thoja moshtarëve të mi që të merren sa më shumë me punë vullnetare sepse nëse jo sot, nesër ose pasnesër do ju kthehet dhe mos jini mendjemëdhenj dhe mos e quani ulje të ndihmoni në të mirën tuaj të prinderve tuaj dhe në të mirë të qytetarëve.

Suela Saliq
Vullnetare



Cdo person zotëron talente dhe aftësi të pafundme. Për këtë arsye, procesi i trajnimit dhe i angazhimit në vullnetarizëm duhet të marrë parasysh aftësitë e panumërta të natyrshme tek të rinjtë dhe tek ata që ndjekin një proces trajnimi. Vullnetarizmi tek të rinjtë që përjetojnë edukimin e bashkëmoshatareve nënkupton një zgjedhje që çon në matjen e vetes dhe të tolerancës .Sot flitet shumë për "edukimin e tolerancës" dhe ky koncept nuk ka një konotacion shumë pozitiv pasi synon të bëjë të ndërgjegjësojë njerëzit për të duruar e për të qenë të mbajtur.

Në realitet është e nevojshme të edukosh me ndjeshmëri dhe të dëgjosh veten, jo të tolerosh. Hulumtimet na lejojnë të konstatojmë se vitet e fundit ekziston një dëshirë e fortë për integrim social të komunitetit që konfirmon kërkimin e autonomisë personale. Mund të mendohet se në vullnetarizmin duke ndihmuar të tjerët, ne ndihmojmë veten dhe kjo është aq e rëndësishme sa pa kaluar këtë përvojë është shumë e vështirë të arrihet pjekuria personale, zhvillimi vetjak si person. Për këtë arsye, trajnimi vullnetar duhet parë si shkolla më e mire e qytetërimit, humanizmit dhe e zhvillimit të aftësive personale.

Për këtë arsye jam bërë pjesë e "World Vision" prej 5 viteve. Si fillim si çdo moshatar i imi isha thjesht një adoleshente e cila ndihmoja me aq pak mundësi sa kisha, por sot jam një koordinatorë e cila mezi pres që grupit tone t'i bashkohet një adoleshent tjetër shut si edhe unë e nisa këtë rrugëtim.

Angazhimi në vullnetarizëm është një ndër eksperiencat e mia më të denja duke e pasuruar veten dita- ditës.

Arlinda Merkuri
Vullnetare



REFLEKSIONE

RINORE

Vullnetarizmi është një nismë ku gjithsecili prej nesh mund të kontribuojë.Pjesa më e madhe e vullnetarizmit vjen nga spontaniteti i tij. Për të rinjtë dhe jo vetem vullnetarizmi është shumë i dobishem pasi është nja angazhim permes së cilit çdokush ka mundësi të përfitojë një përvojë te vlefshme. Vullnetarizmi është një menyrë për t'u takuar me njerëz të ndryshem e për t'u njohur. shkembyer mendime e eksperienca. Unë mendoj që duhet te jemi vullnetarë në çdo aspekt të jetës sepse vullnetarizmi na jep forcë për të dhënë më të mirën tonë.

Klevisa Salla
Vullnetare

